



Universiteti i Prishtinës
Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri
Rr. Eqrem Çabej 111, 10000 Prishtinë

Trajnimi dhe Certifikimi i Auditorëve të Energjisë

Ftohen ekspertët e fushave përkatëse që të aplikojnë në Trajnimin për Auditorë të Energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik i cili organizohet nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri (QEQ) e Universitetit të Prishtinës. Trajnimi planifikohet të mbahet gjatë muajit **Prill/Maj 2025**.

Trajnimi i Auditorëve të Energjisë do të realizohet sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 Për sistemin e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetike, cila rrjedhë nga Ligji Nr. 06/L-079 Për efikasitet të energjisë.

Trajnimi realizohet nga Trajnerët për Auditim të Energjisë të cilët janë të certifikuar nga konzorciumi EIHP (Energy Institute Hrvoje Požar) & FIRE (Federazione Italiana per L'uso Razionale Dell'energia), në vitin 2018.

Bazuar në Shtojcën I të Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020, trajnimi përbëhet prej katër pjesëve si vijon:

- Java e parë dhe dytë – Ligjëratat (minimum 40 orë),
- Java e tretë – Vizitat në teren,
- Java e katërt – Përgatitja, dhe Prezantimi i Raportit të auditimit energjetik, dhe
- Java e pestë – Përgatitja për provim, Provimi përfundimtar (150 minuta).

Në fund të trajnimit, gjatë javës së pestë, parashihet testi me shkrim me një kohëzgjatje prej 150 minutash që rrjedh nga materialet e trajnimit të përdorura në programin e trajnimit dhe kandidatët duhet të kenë arritur kalueshmërinë prej së paku 70%.

Sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020, Kapitulli III, Neni 5, Paragrafi 4, Auditori i Energjisë në ndërtesa për t'u certifikuar duhet të përmbushë kriteret minimale të përshkruara në vijim:

| Kriteret | Pranueshmëria | Shpjegim |
|-------------------------------------|--|--|
| Kualifikimi arsimor/ edukimi | Për auditorët e energjisë në ndërtesa: - Arkitektura, ndërtimtaria, inxhinieri mekanike, inxhinieri elektrike | Këto kualifikime arsimore kërkohen zakonisht në kryerjen e auditimeve energjetike dhe sigurojnë njohuri të mëparshme për sistemet teknike dhe instalime që janë subjekt i auditimit energjetik, duke përfshi përvojën e dëshmuar profesionale. |

| | | |
|-------------------------------|--|--|
| Diploma e kërkuar | Diplomën Master ¹ (së paku 300 pikë të ECTS ²) në Arkitekturë, ndërtimtaria, inxhinieri mekanike, inxhinieri elektrike | Kërkohen 300 ECTS kredi ose ekuivalent sipas programeve të mëparshme arsimore. (p.sh. inxh. i dipl.). |
| Dokumentimi i përvojës | - Së paku 5 vite përvojë profesionale e verifikueshme në projektim, zbatim dhe mbikëqyrje të projekteve arkitektonike, ndërtimore dhe inxhinierike. - CV, referencat dhe lista e projekteve të dorëzohen. | Të dhënat e dokumentuara dhe kohëzgjatja e përvojës së punës do të demonstrojnë ekzistencën e eksperiencave inxhinierike teorike dhe praktike. |

Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret për të ju nënshtruar trajnimit për auditor të energjisë në ndërtesa e të cilët kanë diplomë në inxhinieri elektrike, i plotësojnë kriteret për certifikuar edhe si auditor të energjisë për ndriçimin publik, nëse të njëjtit kalojnë me sukses provimin përfundimtar.

Për shkak të natyrës së trajnimit i cili përmban pjesën teorike dhe pjesën praktike, si dhe për shkak të nevojës që ekipi i auditimit të jetë i përbërë nga profesionistët e fushave përkatëse, trajnimi zhvillohet në grupe prej 6-8 kandidatësh, me shpërndarje afërsisht të njëjtë të kandidatëve nga fushat e inxhinierive të specifikuar në kuadër të kriterëve minimale.

Numri minimal i kandidatëve të paraqitur për të filluar trajnimi është 24 kandidatë, ndërsa numri maksimal është 50 kandidatë.

Afati për aplikim është prej 03 Mars – 21 Mars 2025, ora 16:00.

Pranimi i kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret minimale bëhet në bazë të parimit **kush aplikon i pari**.

Shpenzimet për trajnim, provimin final dhe Certifikatë do të mbulohen nga kandidatët/kandidatet në shumën prej 670 Euro.

Adresa zyrtare për dorëzimin e aplikacioneve është QEQ Prishtinë, vetëm përmes postës elektronike në adresën, qeq@uni-pr.edu.

¹ Sipas kornizës ligjore aktuale në Kosovë, profesionistët me diplomë bachelor nuk i plotësojnë kriteret për t'i kryer detyrat e projektantit.

² ECTS – European Credit Accumulation and Transfer System